

Në bazë të nenit 5 të rregullorës së punës së Këshillit Drejtues thërras mbledhjen e gjashtë me radhë të Këshillit të Përkohshëm Drejtues të Akademisë dhe propozoj këtë:


REND DITE

1. Miratimi I Ekstraktit nga mbledhja e pestë;
2. Miratimi I rregullorës mbi rregullat dhe proceduarat për zgjedhjet e pergjithëshme në Akademi;
3. Miratimi I rregullorës për Zgjedhjet e Studentëve në Akademi;
4. Marrja e vendimit mbi shpalljen e zgjedhjeve të Pergjithshme në Akademi;
5. Formimi i Komisionit Qendror Zgjedhor për Procesin e zgjedhjeve;
6. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 09.12.2021 (e enjte) në ora 10:00.

Kryetari I Përkohshëm I Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



E K S T R A K T

Nga mbledhja e gjashtë e Këshillit të Përkohshëm Drejtues të mbajtur me datë 09.12.2021, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi –Kryetare e përkohshme e Këshillit Drejtues.
2. MSc.Bujar Istogu - Zëvendës Kryetar i Përkohshëm të Këshillit Drejtues
3. Dr.Sc. Fitim Shala – anëtar
4. Muharrem Salihu – anëtar
5. Dr.Sc.Muhamed Krasniqi Drjtor i Akademisë – anëtar pa të drejtë vote;
6. Fatime Krasniqi Sekretare e Përgjithshme e Akademisë - anëtar pa të drejtë vote

Mbledhjen e hapi Kryetarja e Përkohshme e Këshillit Drejtues Dr.Sc. Ema Berisha e cila i falënderoj për prezencën anëtarët e Këshillit dhe propozoi për miratim këtë:

REND DITE

1. Miratimi I Ekstraktit nga mbledhja e pestë;
2. Miratimi I rregullorës mbi Rregullat dhe Proceduart për Zgjedhjet e Përgjithëshme në Akademi;
3. Miratimi I rregullorës për Zgjedhjet e Studentëve në Akademi;
4. Marrja e vendimit mbi shpalljen e zgjedhjeve të Pergjithshme në Akademi;
5. Formimi i Komisionit Qendror Zgjedhor për Procesin e zgjedhjeve
6. Të tjera.

Rendi i ditës i propozuar u miratua unanimisht nga anëtarët e Përkohshëm të Këshillit Drejtues.

I. Miratimi I Ekstraktit nga mbledhja e katërt

Kryetarja Znj. Berisha hapi diskutimin lidhur me Ekstraktin nga mbledhja e pestë, të pranishmit nuk patën asnjë vërejtje apo sygjërim lidhur me Ekstraktin e mbledhës së kaluar të Këshillit prandaj Dr.Sc. Ema Berisha propozoi për votim. Ekstrakti u miratua unanimisht nga anëtarët e Përkohshëm të Këshillit Drejtues.

II. Miratimi I rregullorës mbi Rregullat dhe Proceduart për Zgjedhjet e Përgjithëshme në Akademi;

Kryetarja e Përkohshme e Këshillit Drejtues Zj. Berisha, elaboruan shkurtimisht edhe rregulloren mbi procedurat e zhgjedhjeve të përgjithshme në Akademi, dhe e hapi diskutimin lidhur me këtë rregullore. Sekretarja i Adakdemisë kërkoj fjalën. Znj. Krasniqi për anëtarët e Përkohshëm e Këshillit Drejtues sqaroi se Akademia është fazën e konstituimit si institucion dhe është mëse e nevojshme zgjedhja e organeve të përhershme në Akademi. Sekretarja gjithashtu elaboroi edhe rregulloren shkurtimisht mbi procedurat e zhgjedhjes së përgjithshme, lidhur me rregullimin e procesit zgjedhor dhe përgjegjësit e komisionit qendror zgjedhor etj. Zj. Berisha, falënderoi Sekretarën për elaborimin e rregullores dhe gjithashtu u dha mundësi anëtarëve të tjerë për diskutim. Pasi që nuk pati komente apo vërejtje nga anëtarët e KD -së Kryesuesja propozoi të hudhet në votim në kjo rregullore.

Rregullorja mbi **Rregullat dhe Proceduart për Zgjedhjet e Përgjithëshme në Akademi** u miratua njëzëri nga Anëtarët e Përkohshëm të Këshillit të Drejtues.

III. Miratimi I rregullorjes mbi Zgjedhjet e Studentëve në Akademi

Zj. Berisha, vazhdoi me pikën e tjetër të rendit të ditës Miratimi I rregullorës për Zgjedhjet e Studentëve në Akademi me që rast kërkoj nga Sekretarja e Përgjithshme të Akademisë Fatime Krasniqi të bëjë një prezantim të shkurtër para anëtarëve lidhur me përmbajtjen e kësaj rregullore. Sekretarja, elaboroi shkurtimisht rregullorën për zgjedhjet e studentëve e cila përcakton rregullat rreth zgjedhjeve të parlamentit studentor.

Pas elaborimit, Kryesuesja Zj. Berisha hapi diskutimin lidhur me këtë rregullore. Anëtarët e Përkohshëm të Këshillit Drejtues nuk patë ndonjë vërejtje ose sygjërim dhe rregullorja u hodh në votim.

Anëtarët e Përkohshëm të Këshillit të Drejtues në mënyrë unanime miratuan rregullorën për Zgjedhjet e Studentëve në Akademi.

IV. Vendimi mbi shpalljen e Zgjedhjeve të Përgjithëshme në Akademi

Në kuadër të pikës së katërt të rendit të ditës, Kryesuesja e Përkohshme e Këshillit Drejtues Dr. Sc. Ema Berisha lidhur me vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve në Akademi, sqaroi për anëtarët se Kolegji Akademia Tempulli duke u bazuar në statutin e tij është e rrugës që t'i zgjedh edhe organet e përhershme të saj. Prandaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të hidhet në votim.

Anëtarët e Këshillit Drejtues, e miratua njëzëri popozimin e Kryetares mbi shpalljen e zgjedhjeve në Akademi.

V. Formimi i Komisionit Qendror Zgjedhor për Procesin e zgjedhjeve

Kryetarja e Përkohshme e Këshillit Drejtues Zj. Berisha, për elaburim më të detajuar rreth procesit të zgjedhjeve ja kaloi fjalën Sekretarës së Përgjithshme të Akademisë Znj. Fatime Krasniqi. Sekretarja shpjegoi se bazuar në rregulloret e miratuara sot, Këshilli Drejtues duhet të formojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas rregullores Kyetar i komisionit është Sekretari, një anëtar nga stafi akademik dhe një anëtar nga stafi administrativ. Kryesuesja e KD-së Zj. Berisha, hapi mundësin për propozime për anëtar të komisionit qendror zgjedhor.

Fjalën e mori Z. Istogu i cili propozoi për anëtar të KQZ z. Adem Selmani nga stafi akademik. Sekretarja e Akademisë Znj. Krasniqi propozoi për anëtar të KQZ-së nga administrata Znj. Rajmonda Obri. Propozime të tjera nuk pati.

Kryesuesja e Përkohshme e Këshillit Drejtues Zj. Berisha, propozoi për votim anëtarët e e KQZ-së, Anëtarët e Përkohshëm të KD-së miratuan në mënyrë unanime Komisionin Qendror Zgjedhor

1. Fatime Krasniqi – kryesuese e komisionit
2. Adem Selmani – anëtar
3. Rajmonda Obri -anëtare

Mbledhja përfundoi në ora 12:10.

Të tjera nuk pati në këtë takim.

Kryetari i Përkohshëm i Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi

Procesmbajtësi:
Zj. Makfire Prenqi

